



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Numri i lëndës: 2023:005090  
Datë: 09.10.2024  
Numri i dokumentit: 06273742

K.DH.SH.II.nr.1127/24

Gjykata Komerciale e Kosovës- Dhoma e Shkallës së Dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, me adresës rruga “Armend Daci” nr.1 Prishtinë, kundër debitorit “Enex Trade” Sh.p.k me seli në fshatin Zahaq, Komuna e Pejës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Adem Nikqi, avokat nga Peja duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1905/23 të datës 15.01.2024, me datë 08.10.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitorit “Enex Trade” Sh.p.k me seli në fshatin Zahaq, Komuna e Pejës, e datës 22.02.2024, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1905/23 të datës 15.01.2024, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1905/23 të datës 15.01.2024, në pjesën I të

dispozitivit, ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar prapësimin e debitorit “Enex Trade” Sh.p.k e paraqitur kundër Urdhrit Përmbarrimor P.nr.277/22 të datës 06.12.2022 i lejuar nga Përmbarruesi Privat Jeton Krasniqi dhe i njëjti urdhër mbetet në fuqi në tërësi.

Kundër këtij aktvendimi ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të vlerësimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e paditësit Visar Kelmendi nga Peja, pronar i “Enex Trade” Sh.p.k me seli në fshatin Zahaq, Komuna e Pejës në tërësi si e bazuar. Të anulohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1905/23 i datës 31.01.2024, të vërtetohet se aktvendimi i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM) nr.720 i datës 10.12.2020 si dhe Urdhri Përmbarrimor P.nr.277/22 i datës 06.12.2022 janë lëshuar mbi bazën e dokumentit të lëshuar në mënyrë të jashtëligjshme, procesverbalit të Inspektoratit Komunal të Pejës nr.0000149 të datës 11.12.2019 dhe të njëjtit Hedhen Poshtë si të pabazuara. Të anulohet gjoha administrative e kreditorit KPM në vlerës prej 5,000.00€ (pesëmijë euro) ndaj Enex Trade Sh.p.k. Të detyrohet kreditori KPM që debitorit “Enex Trade” Sh.p.k të ia paguaj shpenzimet procedurale sipas tarifave të OAK-së.

Përgjigje ndaj ankesës se debitorit, ka ushtruar kreditori, duke konsideruar se pretendimet e debitorit nuk qëndrojnë në procedurën përmbarrimore pasi që debitori nuk ka dhënë asnjë nga pretendimet dhe nuk ka përmendur asnjë dispozitë të vetme ligjore se cila është shkelur dhe pa u mbështetur me prova dhe fakte të cilat dëshmojnë një gjë të tillë, nuk paraqet kurrfarë baze ligjore që mund ta kundërshtoj aktvendimin e Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1905/23 i datës 15.01.2024, andaj propozon që të refuzohet ankesa e debitorit si e pa bazuar dhe të vërtetohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1905/23 datë 15.01.2024.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, ka paraqitur propozim për përbarim ndaj debitorit “Enex Trade” Sh.p.k me seli në fshatin Zahaq, Komuna e Pejës, në bazë të dokumentit përbarues-aktvendimit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM), me nr. 720 të datës 10.12.2020 me të cilin është obliguar debitori që kreditorit KPM të ia paguaj shumën në të holla prej 5,000.00€ (pesëmijë euro) në emër të gjobës administrative si rezultat i aktivitetit të jashtëligjshëm minerar.

Përbaruesi Privat Jeton Krasniqi, duke vepruar sipas propozimit për përbarim të kreditorit, me urdhrin përbarimor P.nr.277/22 të datës 06.12.2022, e ka caktuar përbarimin në bazë të dokumentit përbarimor, ndërsa debitori me datë 14.12.2022, ka parashtruar prapësim, duke e kundërshtuar urdhrin P.nr.277/22 të datës 06.12.2022, ashtu siç e ka kundërshtuar edhe aktvendimin e lartcekur i cili është i pa bazuar dhe ngarkon pa bazë “Enex Trade” Sh.p.k me gjobë administrative e cila është e bazuar në informim dhe dokument të pa bazuar dhe tashmë të vërtetuar si të pasaktë, jo real dhe i parregullt. Andaj me anë të prapësimit debitori kërkon që gjykata kompetente konform nenit 72 pika 1.2 të sjell aktvendim të aprovohet prapësimi i debitorit “Enex Trade” Sh.p.k nga Peja si i pa bazuar të Anulohet urdhri përbarimor P.nr.277/22 të datës 06.12.2022 i përbaruesit privat Jeton Krasniqi në Pejë në lidhje me aktvendimin nr.720 i datës 10.02.2020 i KPM-së si i pa bazuar. Të obligohet kreditori KPM që të paguaj shpenzimet e procedurës.

Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.1905/23 i datës 15.01.2024, me të cilin e ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit duke vendosur si në dispozitiv të të njëjtit. Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka theksuar se Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përbarimor, përkatësisht Aktvendimin e KPM-së Nr.720 të datës 10.12.2020, në bazë të së cilit Përbaruesi Privat ka lejuar përbarimin dhe gjeti se i njëjti, konform nenit 22 paragrafit 1. nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përbarues sipas të cilit mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Gjykata gjeti se Aktvendimi i KPM-së Nr.720 i datës 10.12.2020, i përmban të gjitha elementet

e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit. Gjykata vlerëson se në rastin konkret Aktvendimi i lartcekur, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përbarim, organit përbarues i dorëzohet edhe dokumenti përbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përbarueshmërisë për përbarueshmëri”*, dhe paragrafin 2 të po të njëjtit nen, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përbarueshmërinë e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”*, ngase Aktvendimi Nr.720 i datës 10.12.2020, i nxjerrë nga KPMM, është dorëzuar në kopje të vërtetuar sipas ligjit, si dhe është bërë i formës së prerë me datë 08.11.2022 dhe i ekzekutueshëm me datë 24.11.2022, e cila vërtetohet nga vula e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se Dhoma e Shkallës së Parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka marr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj vendimin e gjykatës, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat Dhoma e Shkallës së Dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se vendimi i KPMM-së Nr.720 i datës 10.12.2020, në rastin konkret është dokument përbarues, kjo parashihet në nenin 22 paragrafi 1 pika 1.2 të LPP-së e cila dispozitë përcakton se: *“Dokument përbarues është edhe vendimi përbarues i dhënë në procedurë administrative”* dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përbarimit sipas nenit 21 duke i plotësuar kushtet nga neni 24 paragrafi 3 dhe 27 paragrafi 1 të po këtij ligji ku përcaktohet se: *“Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*. Në këtë rast

Vendimi i lëshuar nga KPMM-së Nr.720 i datës 10.12.2020 është dokument përbarimor dhe i përbarueshëm dhe cilësia e tillë i është konfirmuar me klauzolën e formës së prerë të datës 08.11.2012 dhe klauzolën e ekzekutueshmërisë të datës 24.11.2022 dhe si i tillë është i vlefshëm juridikisht dhe i përshtatshëm për përbarim, pasi që i njëjti i plotëson të gjitha kushtet, ku në të është treguar kreditori dhe debitori, është përcaktuar saktë lartësia e borxhit të debitorit, objekti, lloji, vëllimi dhe koha e përmbushjes së detyrimit nga ana e debitorit, po ashtu i njëjti është dorëzuar në origjinal dhe është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm . Kështu vendimi si dokument përbarimor, ka cilësinë e titullit ekzekutiv dhe është i përbarueshëm, pasi që i njëjti është i pajisur me klauzolën e formës së prerë dhe klauzolën për ekzekutueshmëri dhe si i tillë konform nenit 36 paragraf 1 dhe 2 të LPP-së, sipas këtij titulli përbarimi në këtë rast është i lejuar.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit se lidhur me këtë çështje ka iniciuar konflikt administrativ mirëpo, e refuzoj si të pa bazuar sepse bazuar në dispozitën e nenit 22 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, paraqitja e padisë nuk paraqet pengesë për ekzekutimin e aktit administrativ në procedurën përbarimore dhe si rrjedhojë nuk e ndalon përbarimin. Po ashtu kjo gjykatë vlerësoj edhe pretendimet tjera ankimore po që i refuzoj si të pabazuar për shkak se nuk kishin ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje përbarimore, sepse gjykata apo përbaruesi privat në procedurë përbarimore i përmbahet parimit të rigorozitet formal juridik, nga i cili parim rrjedh se gjykata-përbaruesi privat e vlerëson përshtatshmërinë e dokumentit përbarimore, vlerëson nëse janë plotësuar kushte për nxjerrjen e urdhrin përbarimor dhe në procedurën sipas prapësimit gjykata e shkallës së parë i vlerëson shkaqet e treguara në prapësim nga neni 71 i LPP-së.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale Dhoma e Shkallës së Dytë në Prishtinë për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1127/24, me dt.08.10.2024

Gjyqtarja  
Franciska Zhitija Ymeri